



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 235 Prot.

Tiranë, më datë 04.04.2025

VENDIM

Nr. 212, datë 04.04.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "*Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale*", Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 "*Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj*", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 04.04.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e projektit "*Riparimi i biletarisë në Parkun Kombëtar Butrint*", Brenda Kufirit Park Arkeologjik, me aplikues dhe zhvillues **Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit**;
2. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Joli MITROJORGJI



KRYETAR

Blendi GONXHJA